
LAJMËRIM PËR MEDIA

Shoqata për zhvillim individual, organizativ dhe shoqëror “RRITJE DHE ZHVILLIM Shkup” në datë 1 Korrik 2020, filloi me realizimin e projektit “Sfido veten dhe bëhu aktiv”, i finansuar nga Grupi 484, me Marrëveshje për grant.

Projekti paraqet përgjigje direkte për krizën globale ekonomike, sociale, shëndetësore të shkaktuar nga Kovid-19.

Konkretisht, gjithësej 10 shkolla fillore nga Republika e Maqedonisë Veriore, nga 8 regjionet statistike dhe me përbërje heterogjene demografike, do të marrin pjesë në aktivitete/ushtrime online <http://predizvik15.mk/>, të cilat pritet që të stimulojnë aktivitet fizik te nxënësit prej klasës së 6të deri 9të, në kushte shtëpiake (me ose me pak mjete), të krijuara nga profesionist i kualifikuar dhe edukator i edukatës fizike.

Ky lloj aktiviteti konsiderohet veçanërisht i rëndësishëm, sepse shkollat në shtet janë të mbyllura që nga Marsi 2020, ndërsa pritet që gjendja të vazhdojë deri në vitin tjetër shkollor. Në projekt parashikohet që të marrin pjesë 300 fëmijë në moshë prej 10 deri në 14 vjet, më bashkëpunim me 10 profesorë të edukatës fizike të shkollave të caktuara fillore. Për ushtrimet e kryer suksesshëm pjesëmarrësit do të fitojnë pikë dhe do të garojnë me moshatarët e vet nga shkollat tjera. Secila nga shkollat e përfshira do të fitojë donacion të mjeteve sportive në kuadër të projektit, sipas nevojave të tyre.

Projekti nënkupton edhe dy online hulumtime në fazën e dytë, të cilët përveç se evaluimit të aktiviteteve dhe matjes së kënaqësisë nga vetë programi edukativ, do të mundësojë edhe të dhëna për qëndrimet dhe mendimet e pjestarëve për rëndësinë e edukatës fizike në shtet si dhe sugjerime për përmirësimin e kualitetit të arsimit dhe kurikulimit/metodave dhe teknikave, të cilat si e-broshurë do të shpërndahen deri te të gjithë institucionet relevante (Ministria e arsimit dhe shkencës, Agjensioni për të rinj dhe sport, Byroja për zhvillim të arsimit etj.).